



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.09.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri-Kosovë 2014-2020, alokimet e vitit 2017.”

2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin për lehtësimin e tregtisë dhe të transportit në Ballkanin Perëndimor me qasje programatike me shumë faza.”

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Ditmir Bushati, Eglandina Gjermani, Ralf Gjoni, Vasil Sterjovski, Andrea Marto, Adnor Shameti, Ervin Bushati, Vasilika Hysi, Ligoraq Karamelo dhe Rudina Hajdari.

Mungojnë:

Elona Hoxha dhe Evis Kushi.

Të ftuar:

Sokol Dedja - Zëvendësministër për Europën dhe Punët e Jashtme

Gentian Xhaxhiu - Përgjegjës sektori në Drejtorinë e Fondeve të BE-së

Erjon Luçi - Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita!

Sot, në mbledhjen e radhës së Komisionit të Politikës së Jashtme, të datës 11 shtator, në rendin e ditës kemi diskutimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës dhe Komisionit Europian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri-Kosovë 2014-2020, alokimet e vitit 2017.” Në komisionin për dhënie mendimi relatore kemi ish-ministren Gjermani.

Pika e dytë e rendit të ditës është projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin për lehtësimin e tregtisë dhe të transportit në Ballkanin Perëndimor me qasje programatike me shumë faza.” Relator i këtij projektligji është deputeti Bushati (ai i duhuri, do të thoshte Adnor Shameti).

Për të diskutuar për të dyja projektligjet kemi të ftuar zotin Sokol Dedja, zëvendësministër për Europën dhe Punët e Jashtme, zotin Gentian Xhaxhiu, përgjegjës sektori në Drejtorinë e Fondeve të BE-së, si dhe të përhershmin, zotin Erjon Luçi, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë.

Mirëserdhët!

Na keni munguar, zoti Luçi! Më mungojnë homologët, kolegët...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jeni bërë shumë zëvendësministra këto kohët e fundit.

Zoti Dedja, ju lutem, na thoni shkurtimisht dy fjalë për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Shqipërisë, Kosovës dhe Komisionit Europian!

Faleminderit!

Sokol Dedja – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar anëtarë,

Projektligji që po diskutojmë ratifikon marrëveshjen e financimit me alokimet e vitit 2017, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar Shqipëri-Kosovë.

Marrëveshja është nënshkruar pas miratimit në parim nga Këshilli i Ministrave dhe për këtë vit përmban grantin e Bashkimit Europian prej 8 milionë e 400 mijë eurosh. Kjo do të thotë që Kuvendi i ka miratuar tashmë alokimet e viteve financiare 2014, 2015 dhe 2016. Prandaj, po ndalem shumë shkurtimisht në përshkrimin e programit.

Për gjithë programin e bashkëpunimit ndërkufitar Shqipëri-Kosovë, pra për gjithë ciklin financiar 2014-2020, shuma e alokuar është 8 milionë e 400 mijë euro.

Përfituesit e këtij programi në Shqipëri janë qarku i Lezhës dhe qarku i Kukësit.

Programi synon zhvillimin socio-ekonomik të zonave ndërkufitare, duke forcuar bashkëpunimin, duke rritur kontaktet midis administratave vendore dhe qendrore të të dyja vendeve, të aktorëve të shoqërisë civile dhe operatorëve ekonomikë, duke rritur shkëmbimin e eksperiencave, si dhe përmirësimin e politikave publike.

Objektivat ku përqendrohet programi.

Në gjuhën e programit të bashkëpunimit ndërkufitar, një prioritet tematik është mbrojtja e mjedisit, duke përfshirë përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe menaxhimin e rreziqeve.

Prioriteti tjetër është inkurajimi i turizmit, duke përfshirë edhe trashëgiminë kulturore dhe natyrore.

Prioriteti i tretë tematik i këtij programi është investimi në rini, punësim, aftësi dhe arsim.

Ratifikimi i marrëveshjes i hap rrugë zbatimit konkret të projekteve nëpërmjet thirrjeve që shpallen.

Është shpallur thirrja e dytë për aplikime në projektet e bashkëpunimit ndërkufitar Shqipëri-Kosovë. U shpall në maj dhe në fund të gushtit përfundoi procesi i aplikimeve, që vlerësohen nga delegacioni i Bashkimit European.

Faleminderit!

Mimi Kodheli - Fjalën e ka ish-ministrja Gjermani.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, kryetare!

Faleminderit, zoti zëvendësministër!

Ratifikime të tilla të marrëveshjeve të financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar, kemi kaluar disa herë në komision. Pa dyshim, kemi vlerësuar rëndësinë dhe impaktin që kanë këto financime në zhvillimin dhe forcimin e marrëdhënieve të shkëmbimit kulturor, tregtar, ekonomik dhe social mes Shqipërisë dhe Kosovës.

Të dyja qarqet e përzgjedhura, qarku i Lezhës dhe i Kukësit, do të kenë përfitime nga projektet dhe programet, që do të realizohen mes Shqipërisë dhe Kosovës.

Fakti që janë hapur aplikimet dhe do të ketë aplikime edhe nga shoqëria civile, edhe nga pushteti vendor, mendoj që projektet do të kenë impakt të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve të këtyre komuniteteve, si në Shqipëri, ashtu edhe në Kosovë. Fakti tjetër, që

projektet i zgjedh Bashkimi European, besoj se është një kriter për të garantuar impaktin, cilësinë dhe standardet e projekteve.

Edhe herët e tjera, kur kemi diskutuar të tilla projektligje në komision, është bërë një raportim i përmbledhur se si dhe çfarë janë realizuar deri tani, sepse ne kemi kaluar disa nga këto në komisione dhe nuk kemi informacion se çfarë projektesh janë financuar realisht nga grantet e mëparshme, se çfarë impakti kanë pasur ato dhe cilët kanë qenë përfituesit dhe përvojat pozitive, mbi bazën e të cilave mund të ngrihen edhe modelet e projekteve në vazhdim.

Në qoftë se ju keni ndonjë informacion sot, dakord. Në qoftë se nuk keni, do t'ju lutesha të na e dërgoni me *e-mail*, që të mund të kemi një informacion të detajuar për projektet e realizuara deri tani me këto grante apo marrëveshje, që i kemi kaluar edhe në parlament.

Ju faleminderit!

Mimi Kodheli- Faleminderit!

A ka pyetje dhe diskutime?

Po, zoti Gjoni.

Ralf Gjoni - Faleminderit, zonja kryetare!

Zoti zëvendësministër, faleminderit që keni ardhur! Ju falënderoj edhe për shpjegimin konciz që bëtë!

Në përgjithësi, kur bëhet fjalë për marrëveshje bashkëpunimi të financuara nga fonde të konsiderueshme europiane, bëhet fjalë edhe për mundësi shumë të mëdha abuzimi, duke pasur parasysh praktikat e mëparshme korruptive dhe nivelin galopant të korrupsionit në këto dy vende të Ballkanit, si Shqipëria dhe Kosova, si dhe problematikat e ngritura nga zyrat përkatëse të Bashkimit European për abuzimet me fonde europiane, jo vetëm në vende si Shqipëria dhe Kosova, por edhe në vetë vendet anëtare të Bashkimit European.

Nga mënyra se si është prezantuar projekti, në këtë marrëveshje shikoj që ka mungesa të theksuara në marrjen e masave të nevojshme për ta mbikëqyrur këtë program të përbashkët.

Nuk shoh një mekanizëm të kënaqshëm për monitorimin e projektit, fizibilitetin e tij, për të parë prekmërinë e projektit në terren. Nuk jam i sigurt se kush do ta monitorojë dhe çfarë kapacitetesh keni parashikuar për të monitoruar që këto fonde realisht të shkojnë te përfituesi i destinuar.

Ka edhe një problem, që e kemi ndarë si shqetësim ndër vite: shpeshherë në projektet europiane hidhen miliona euro nga taksapaguesit europianë në vende joanëtare ose në vendet

kandidate për anëtarësim në Bashkimin Europian, si Shqipëria apo fqinjët tanë. Fondet hidhen nga Bashkimi Europian, emërohen disa pseudoekspertë të gjithëditur për të implementuar ose për të bërë konsulencën në vende si Shqipëria dhe fondet kthehen sërish në vendet anëtare të Bashkimit Europian.

Pra, çfarë përfitimesh kanë, realisht, jo vetëm përfituesit në terren të Shqipërisë, por edhe ekspertët, sepse ka shumë ekspertë, konsulentë shqiptarë, që janë shumë të aftë (në dijeninë time, janë edhe më të aftë se shumë homologë europianë)? Pra, çfarë masash keni marrë ju, si ministri?

Çfarë parashikoni si hapësirë përfituese për kompanitë dhe konsulentët shqiptarë? Sepse, në fund të fundit, këto paratë e hedhura duhet t'i përfitojnë shqiptarët, por edhe kompanitë dhe konsulentët shqiptarë, në një treg për të cilin do të thosha se është i kënaqshëm për sa i përket nivelit të ekspertizës lokale, që besoj se është ekspertiza kryesore në këto raste.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – A ka pyetje të tjera?

Po, zoti Karamelo.

Ligoraq Karamelo – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti zëvendësministër, për sqarimet!

Këtë marrëveshje e konsideroj si një hap shumë pozitiv. Pa dyshim, kjo tregon se ecën bashkëpunimi dhe koordinimi me BE-në për këto projekte. Më vjen mirë që janë zgjedhur dy qarqe të zonës veriore, që kanë nevojë! Besoj se kjo do të ndikojë në zhvillimin e sektorëve, ku janë programuar...

Desha një sqarim, në vijim edhe të asaj që tha edhe kolegja Gjermani. Nga përvoja ime, të paktën këto vitet e kaluara, kam tentuar shpeshherë, për sa i përket bashkëpunimit ndërkufitar edhe në rajonin e Korçës edhe të Jugut të Shqipërisë me Greqinë, dhe kam konstatuar që nuk ka pasur ndonjë përparim të dukshëm në këtë drejtim. Me sa konstatoj, mendoj se ndoshta defekti është tek institucionet e qarkut apo edhe tek institucionet e tjera, që merren drejtpërdrejtë me hartimin e projekteve. Nuk e di nëse ka mungesë dëshire bashkëpunimi, aftësie apo koordinimi, por besoj se Ministria e Jashtme duhet të luajë një rol të rëndësishëm në këtë aspekt. Shqipërisë i intereson të thithë sa më shumë projekte për bashkëpunimin ndërkufitar nga BE-ja, aq më tepër që pozicioni ynë gjeografik dhe interesi është që të ecim dhe të jemi më afër Europës në këtë aspekt, sepse kemi një vend si Greqia ose Italia dhe duhet ta shfrytëzojmë.

Nuk dua të vazhdoj të diskutoj më tej, por dua të them se jam dakord me marrëveshjen dhe uroj që ajo të ketë sa më shumë efektivitet!

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ku të doni.

Zoti Bushati, fjala është për ju.

Ditmir Bushati – Faleminderit, zonja kryetare!

Për sa i përket kësaj marrëveshjeje, fillimisht dua të deklaroj mbështetjen dhe votën time pro. E tha edhe zonja Gjermani, por me sa kuptova edhe nga shqetësimet apo parashtrimet që u bënë nga dy kolegët e tjerë, Gjoni dhe Karamelo, këtu jemi përballë një shqetësimi pak më të madh dhe ndoshta si komision, së bashku me strukturat e qeverisë, duhet të përpiqemi ta adresojmë në mënyrë pak më holistike çështjen për përthithjen e fondeve. Nga eksperiencia ime e mëparshme në ekzekutiv, sa herë kemi ardhur këtu për marrëveshje të tilla, diskutimi i drejtë i deputetëve ka pasur lidhje kryesisht me numrin e projekteve të fituara nga Shqipëria dhe projektet e fituara nga shtetet e tjera pjesëmarrëse në këtë program.

Në kuadër të kërimit të informacionit, që u tha edhe nga zonja Gjermani, por duke pasur parasysh që është prezent edhe zëvendësministri i Financave, edhe Ministria e Financave ka një rol jo ekzaktesisht për këtë fushë që diskutojmë sot, por përgjithësisht për programet e financuara nga ana e Bashkimit Europian, ndoshta si pjesë e këtij informacioni të ishte edhe një analizë mbi dobësitë që ne kemi në këtë drejtim.

Unë e di që zëvendësministri Dedja ka bërë një parashtrim përpara kabinetit qeveritar në lidhje me nivelin e absorbimit të fondeve. Këtë javë ne do të kemi në Kuvend një diskutim për marrëveshje koncesionare në fushën e infrastrukturës. Na ka kaluar Samiti i Poznanit, ku kemi disa projekte dhe shifra, që tashmë janë informacione zyrtare nga ana e Bashkimit Europian, të përfituara nga vende të tjera, kemi pasur disa përpjekje serioze për themelimin e *Single Project Pipeline* dhe ndoshta është momenti për të bërë rishikimin dhe për të kuptuar ku jemi në atë drejtim. Nga eksperiencia, mendoj se në rast se do t'i referohemi thjesht dhe vetëm sa fonde janë fituar dhe sa projekte janë përzgjedhur me këtë program, kam frikë se do të fokusohemi te pema dhe do të humbim pyllin.

Duke pasur një analizë ndoshta më të kthjellët, ne kemi mundësi t'i japim mbështetje strukturave të ekzekutivit, duhet të kemi edhe një vullnet më të gjerë politik, jo thjesht si pjesë e maxhorancës, por, me sa kuptova, shqetësimi është edhe më i gjerë, pra, edhe për të

fuqizuar kapacitete që janë jashtë administratës publike, por që në fund të ditës janë investime dhe kapital njerëzor për Shqipërinë, në mënyrë që të kemi një pozicion sa më të qartë në këtë drejtim.

Pra, unë do të kërkoja që informacionit që kërkon zonja Gjermani t'i shtohen edhe këto elemente që parashtrova, duke shprehur mbështetjen për këtë marrëveshje që vjen.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Bushati!

Zoti Dedja, fjala është për ju.

Sokol Dedja – Faleminderit për pyetjet!

Për sa i përket pyetjes së parë të zonjës Gjermani për projektet, përfitimet e Shqipërisë, impaktin e tyre, ka një mënyrë funksionimi të projekteve të bashkëpunimit ndërkuftar, sipas së cilës zbatimi konkret i projekteve fillon tre vjet pas vitit kalendarik për të cilin alokohen fondet. Kjo do të thotë që për të gjitha projektet e këtij cikli financiar, fondet e viteve 2014, 2015, 2016, 2017, nuk kemi ende projekte të përfunduara. Domethënë, fondet e vitit 2014 dhe vitit 2015 kanë shkuar për thirrjen e parë për projekte bashkëpunimi, e cila ka përfunduar, projektet janë përzgjedhur në mars të vitit 2018, që do të thotë sapo ka filluar zbatimi i tyre, kurse fondet e këtij viti do të bashkohen me fondet e vitit ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, është bërë përzgjedhja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përzgjedhja e projekteve ka përfunduar në muajin mars të vitit 2018.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë projekte që kanë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Matja e impaktit është e vështirë të bëhet pa përfunduar zbatimi i projektit. Prandaj ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për sa i përket skedulimit, brenda afateve të përcaktuara nga delegacioni i Bashkimit Europian, është zhvilluar i gjithë procesi i aplikimit dhe përzgjedhjes. Për thirrjen e parë janë pesë projekte fituese dhe totali është 2,2 milionë euro. Kurse thirrja e dytë, që përfshin edhe fondet e këtij viti, është ende në proces. Për të parë impakt dhe projekte të suksesshme, duhet të shikojmë ciklin paraardhës financiar, 7- vjeçarin para vitit 2013. Domethënë, fondet përpara vitit 2013, por zbatimi disa vite më vonë.

Një projekt i suksesshëm, që do të përmendja në kuadër të këtij cikli financiar, është konstruksioni i pikës doganore Shishtavec - Krushevë dhe rehabilitimi i rrugëve të

brendshme, që lidhin pikën doganore me fshatin Shishtavec dhe shtrimi me kalldrëm brenda fshatit Shishtavec. Është një projekt me rezultate të prekshme me vlerë 2,5 milionë euro, zbatimi i të cilit ka përfunduar në muajin maj të vitit 2018.

Për sa i përket pyetjes së dytë për monitorimin, zbatimin financiar të projektit dhe eliminimin e abuzimeve, më duhet të them se monitorimi financiar bëhet nga delegacioni i Bashkimit Europian. Është përgjegjësi e tyre eliminimi i ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Siç bëhet përzgjedhja e projekteve, pas një thirrjeje të hapur nga delegacioni i Bashkimit Europian në Tiranë, ashtu edhe monitorimi financiar kryhet nga delegacioni i Bashkimit Europian në Tiranë.

Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme monitoron zbatimin e aktiviteteve në anën shqiptare, siç parashikohet në projekte që kanë rezultuar përfituese pas përzgjedhjes nga delegacioni i Bashkimit Europian. Sigurisht, ekziston edhe një sekretariat teknik i përbashkët me Kosovën, me seli në Kukës, që monitoron zbatimin e projekteve.

Sigurisht, çështja e kapaciteteve përthithëse ishte një shqetësim i përbashkët i të gjitha pyetjeve që u ngritën. Kjo është një sfidë dhe ka shumë për të bërë në këtë drejtim. Shumë herë, në shumë projekte të bashkëpunimit ndërkufitar, përfitues janë njësitë e pushtetit vendor, prandaj sfidë e rëndësishme është forcimi i kapaciteteve të tyre. Procesi i krijimit të njëjësive të integritetit europian në bashki, ndihmon dhe është një hap i mirë në këtë drejtim.

Për sa i përket pyetjes për zona të tjera, jo këto që diskutohen sot, në Jug është programi i bashkëpunimit ndërkufitar me Greqinë me 45 projekte që nga viti 2016, që janë në zbatim.

Faleminderit, zot Bushati për interesimin, për kërkesën për analizë për problematikën në përthithje jo vetëm të programeve të bashkëpunimit ndërkufitar, por në përgjithësi për problemet e përthithjes së asistencës financiare të BE-së për dobësitë që shfaqen në këtë drejtim! Jemi të gatshëm t'i dërgojmë komisionit një analizë për këtë gjë.

Mimi Kodheli - Faleminderit, zoti Zëvendësministër!

Në fakt, ky është një shqetësim i përbashkët, ashtu siç e thatë edhe ju dhe për shumë gjëra që diskutojmë sa herë që flitet për marrëveshje të kësaj natyre. Në Shqipëri në këta 30 vjet nëse do t'i mblidhnim të gjitha marrëveshjet e financimeve ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe këtu po flas për pushtetin vendor, për pushtetin lokal, OJF-të dhe Komisionin Europian apo me të gjithë strukturat me natyrë financiare ose ndërkombëtare, Shqipëria do të ishte, besoj një ndër vendet më të zhvilluara jo vetëm në rajon, por edhe më tepër sesa kaq. Për fat të keq nuk jemi aty ku duhet. Nuk është se në këtë mbledhje ne do ta

zgjidhim këtë gjë. Unë besoj se çdo fillim i mirë është gjithmonë gjysma e punës. Ne kemi kërkuar edhe herë tjetër nga institucioni juaj të na sillni informacione në vazhdimësi të çdo projektligj që ka të bëjë me ratifikimin e marrëveshjeve. Në dijeninë time apo në *e-mail*-in tim ka pak informacion për të mos thënë aspak. Pra, ka ardhur një herë, ndërkohë që ne ratifikojmë pafundësisht marrëveshje të të gjitha natyrave, sidomos të kësaj natyre që po flasim sot. Nuk duhet t'ia lëmë vetëm delegacionit apo komisionit të monitorojë se si shkon projekti, pavarësisht se paratë e tyre janë, por përkundrazi ne jemi akoma më të interesuar si përfitues rajonalë apo qendrorë të gjithçkaje që vjen, hyn në Shqipëri: para të taksapaguesve të vendeve europiane.

Nga ana tjetër duhet që këtë gjë ta ndajmë bashkërisht, në mënyrë që të mundësojmë jo vetëm një supervizim *ex cathedra* të gjithçkaje që ndodh, sepse këto projektligje kalojnë edhe në komisionin tonë dhe mund të jemi më shumë sesa supervizorë, një suport, një ndihmesë, sepse përpara se të jemi anëtarë të këtij komisioni, jemi deputetë të zonave të caktuara dhe fare mirë rritjen e kapaciteteve ta bëjmë edhe nëpërmjet një involvimi, angazhimi më të madh në projekte të kësaj natyre.

Ju keni një strukturë të caktuar, ku zoti Xhaxhiu është përgjegjës për këtë gjë dhe nuk ka nevojë të kalojë nëpërmjet instancave, strukturave të larta, por edhe drejtpërdrejt në komunikim me ne. Ne nuk është se ofendohemi pse një drejtor drejtorie apo një shef sektori na dërgon një informacion, përkundrazi, në mënyrë që ne të jemi suport, ndihmesë, mendje, një ide e shtuar, një monitorim i shtuar, i të gjitha këtyre parave që hyjnë në Shqipëri. Shumëkush prej nesh e di se si funksionon, e dimë strukturimin, e dimë se sa pavarësi ka OJF-ja apo pushteti lokal në të tilla raste. Por më besoni, ju flisni për një pikë në Shishtavec, unë jam deputetë e asaj zone, e di shumë mirë se çfarë po bëhet në njësinë administrative të Shishtavecit, është shumë e mirë kjo që po ndodh, por ka pafundësisht gjëra që mund të bëhen edhe me shumë më pak para nga sa harxhohet nga ajo që lexojmë këtu. Është impresionuese jo vetëm për një qytetar të thjeshtë, por edhe për ne kur thoni: “2,2 milionë euro”. Pra, nuk e them, se konkretisht ky projektligj për këtë marrëveshje meriton një diskutim kaq të gjatë, por është një emocion që ne jemi ngarkuar në vite, sepse harxhohen shumë dhe përfitimi është minimal. Më besoni, qarku i Kukësit dhe këtu përfshij Kukësin, Has – Tropojë, statistikisht ka mbase përqindjen më të lartë të largimeve të rinisë nga vendi. Si do ta bëjmë atraktive për rininë tonë zonën e tyre, vendin e tyre të mrekullueshëm ku jetojnë? Edhe një projekt 2, 2 prej milionë eurosh ndihmon, e madje edhe një projekt shumë më i vogël se kaq, por që ta bëjmë këtë duhet të jemi më të involvuar. Me tridhjetë e shtat vjetët e eksperiencës sime, unë ju ftoj që të na angazhoni më tepër. Më strukturën që keni,

është e pamundur të mund t'i menaxhoni të gjitha. Ne e kemi shumë të thjeshtë: vini këtu, ratifikoni, ata sjellin ca para, ka disa struktura që monitorojnë, ata monitorojnë paratë e tyre, marrin ca rroga të majme, bëjnë sikur bëjnë punët e tyre, nuk e di a i bëjnë, se s'jam këtu për t'i gjykuar. E ripërsëris, dhe dua të falënderoj pafundësisht, deri në përlujtje, çdo donator që ka hedhur para në Shqipëri. Problemi është se ne duhet t'u marrim maksimumin parave që hidhen këtu. E ne si komision, dhe ju si përfaqësues të lartë të ministrisë më të rëndësishme të qeverisë, siç është Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, të mund të kemi një këndvështrim tjetër mbi *puzzle*, jo të merremi me arna. Pra, që ne të mund ta shikojmë këtë gjë me një strategji ndryshe, ta ndryshojmë qasjen dhe mënyrën sipas të cilës ne si qeveri, ne si parlament monitorojmë gjithë këto projekte.

Mund të ndërtonim bashkërisht një ministritë, të bënim një inventar të të gjitha projekteve që janë *vivid*, dhe të shohim ku jemi, cilat janë përfitimet, si është harta, si është e mbuluar Shqipëria? Se mund të ketë rajone dhe zona, në të cilat është investuar, janë derdhur shumë para donatorësh, por mund të jetë përfitimi i vogël ose zbatimi i deformuar, siç mund të ketë zona që s'janë të mbuluara fare, por të cilat mbase mund të kenë aftësi thithëse e mundësi më të mëdha zbatimi.

Sigurisht, e thënë në tryezë me vetëm dy fjali tingëllon shumë e thjeshtë, por në praktikë nuk është gjë e thjeshtë. Ja ku jemi, ja ku është përfaqësuesi i lartë i Ministrisë së Financave, ju jeni gjithashtu, edhe komisioni ynë është disponibël. Besomëni, është fat i madh që ne në këtë komision biem dakord në shumëçka dhe jemi të gjithë njëzëshëm kur vjen puna për të ratifikuar sidomos marrëveshje të kësaj natyre.

Mendoj se është momenti që ne ta ngremë cilësisht këtë marrëdhënie.

Ndonjë diskutim tjetër?

Po, zoti Gjoni, fjala për ju!

Ralf Gjoni – Faleminderit!

Zoti Zëvendësministër!

Në fakt, unë jam i pakënaqur me përgjigjen tuaj, sepse nuk mora përgjigje për pyetjen time. Ju përfaqësoni këtu Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, pra ju përfaqësoni shtetin shqiptar. tani, për zbatimin e këtij projektligji që propozohet, ngarkohet Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, në cilësinë e saj si koordinatore kombëtare e asistencës së BE-së për Shqipërinë.

Ju lutem, zoti Zëvendësministër, ndoshta duhet të kuptojmë pak detyrat dhe përgjegjësitë reciproke. Ju jeni pjesë e ekzekutivit. Këtu jeni në parlament. Ju e keni detyrim të raportoni në parlament dhe t'u përgjigjeni shqetësimeve të deputetëve, sidomos të këtij

komisioni të nderuar, kur vjen fjala për një çështje kaq të ndjeshme dhe të prekshme, sa i përket përthithjes dhe efikasitetit të përdorimit të miliona fondeve europiane përgjatë viteve, por edhe tani e në të ardhmen dhe për sa u përket benefiteve që Shqipëria, qytetarët shqiptarë, por edhe kompanitë dhe konsulentët shqiptarë do të kenë nga këto fonde.

Më vjen keq, zoti Zëvendësministër, por nuk mundet që një përfaqësues i shtetit shqiptar të thotë se përgjegjësia për monitorimin dhe për përzgjedhjen e implementuesve të këtij projekti i takon delegacionit të Bashkimit European në Tiranë. Pra, nuk mundet që një shtet i tërë të gjunjëzohet para një zyre teknike të një delegacioni. Unë nuk besoj se delegacioni i Bashkimit European në Tiranë i ka kapacitetet e mjaftueshme për të monitoruar një projekt të tillë rajonal. Unë besoj se ajo që tha kryetarja, zonja Kodheli, është shumë e vlefshme, sepse ne, si parlament, e kemi shumë të nevojshme që të marrim raportime të shpeshta dhe cilësore nga ana juaj. Ndoshta duhet një koordinim dhe një bashkëpunim më i fortë ndërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe parlamentit për sa i përket implementimit të këtyre projekteve dhe fondeve europiane. Ndoshta duhet parë nga fillimi e gjithë strategjia se si implementohen këto projekte në terren. A ka mundësi që kjo marrëveshje të rishikohet, duke pasur në konsideratë shqetësimet që u ngritën sot në komision? Unë do të doja shumë ta votoja këtë marrëveshje specifike që ju keni sjellë këtu, por e kam shumë të vështirë ta votoj, sepse nuk garantohej asnjë aspekt i monitorimit nga strukturat shtetërore shqiptare. Besoj se po më dëgjoni, apo jo? Pra, nuk ka asnjë garanci nga strukturat shtetërore se si do të monitorohet ky projekt. Ju nuk mund të mjaftoheni thjesht me faktin se këtë gjë e bën delegacioni dhe hajde t'ia hedhim topin delegacionit se ai e merr përsipër. Në asnjë mënyrë jo.

Zonja kryetare, unë sugjeroj që ne këtu, si anëtarë të Komisionit të Jashtëm, të marrim kontaktet e nevojshme me të gjithë kolegët tanë në Parlamentin European, por edhe në Komisionin European, pasi unë jam i sigurt se vendet anëtare të BE-së, por edhe anëtarët e Parlamentit European do të ishin shumë të interesuar të kuptonin se si përdoren dhe si implementohen paratë e taksapaguesve europianë, të vendeve respektive të BE-së, në vendet si Shqipëria.

Unë mendoj se duhet një seriozitet më i madh nga ana juaj në përgjigje të shqetësimeve të ngritura nga deputetët.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Po, zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani - Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, në relacion, thjesht për të mbështetur atë që tha zëvendësministri, Shqipëria dhe Kosova do të bashkëpunojnë ngushtë me delegacionin e BE-së në Tiranë për koordinimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të programit. Pra, do të jenë të gjithë aktorët bashkë.

Struktura institucionale e programit është e përbërë nga autoriteti kontraktues, Komiteti i përbashkët i monitorimit, sekretariati i përbashkët Teknik, si dhe koordinatorët kombëtarë të fondeve IPA të të dyja vendeve përfituese. Pra, kolegë, përgjegjësinë nuk e ka vetëm BE-ja, sepse të gjithë aktorët, qeveritë tona dhe koordinatorët ndërkombëtarë kanë pjesën dhe angazhimin e tyre. Unë jam dakord që duhet të kemi më shumë informacion dhe raportim për programet dhe projektet e fituara që do të jenë në vazhdim. Prandaj, në momentin që këtu vjen një projekt i ri ne duhet të kemi më shumë informacion për të.

Ndërkohë, dua ta mbyll me faktin e rritjes së kapaciteteve, sigurisht te pushteti vendor dhe tek organizatat jofitimprurëse, për sa i përket shpërndarjes së informacionit. Edhe herën e kaluar që diskutuam ne kërkuam që të shpërndahet sa më shumë informacion tek aktorët e interesuar, madje në mënyrë të veçantë tek universitetet, jo vetëm te pushteti vendor dhe tek organizatat jofitimprurëse.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zonja Gjermani!

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi - Faleminderit, zonja kryetare!

Duke ju uruar gëzuar ditëlindjen, do të doja të bëja në sugjerim. Unë i shikoj shumë me vend rekomandimet dhe sugjerimet që bënë të gjithë kolegët parafolës.

Ne sot ratifikojmë një marrëveshje pjesë e së cilës është edhe modeli i raportit vjetor të zbatimit të marrëveshjes ndër vite. Unë pajtohem me konstatimin dhe sugjerimin qoftë të zonjës Gjermani, por edhe të zotit Gjoni, që nuk ka detyrim Bashkimi Europian.

Poi lexoja me vëmendje raportin vjetor të zbatimit, shtojcën 3/a dhe shtojcat e tjera, si dhe modelin e raportit vjetor. Unë do të sugjeroja që për të gjitha raportet dhe projektet që do të ratifikohen në Kuvendin e Shqipërisë ne të marrim kopje të raportit vjetor, sepse çdo institucion e sjell raportin përkatës, si: Banka e Shqipërisë, KLSH-ja e të tjera, por për grandet, sidomos për huatë nuk marrim raporte. Pra, ne thjesht ngremë dorën dhe miratojmë, por nuk kemi asnjë informacion lidhur me efektivitetin e tyre. Kjo është e detyrueshme, zoti Zëvendësministër, edhe për shkak të një ndryshimi që kemi bërë në Rregulloren e Kuvendit.

Në Rregulloren e Kuvendit, kur miratuam ndryshimet në korrik të vitit 2019, ne kërkuam të bënim një *post evolution* për çdo vlerësim, çdo grant, marrëveshje apo ligj të

miratuar. Në këtë kuadër, ne përmbushim jo thjesht detyrimin e funksionit si ligjbërës dhe atë të kontrollit parlamentar, por, njëkohësisht, sikurse me të drejtë e tha zonja Gjermani, ne jemi përfaqësues, jemi të zgjedhur. Atëherë, si do t'u japim ne përgjigje shqetësimeve dhe problematikave të zonave që ne përfaqësojmë, në qoftë se nuk kemi këtë lloj informacioni? Pa dyshim, ky informacion nuk duhet të jetë vetëm në raportet teknike të zyrës së Bashkimit Europian, por ai që ka propozuar projektligjin, në kuadër të programit të transparencës, në faqen zyrtare *online* të institucionit, duhet t'i botojë këto raporte. Kjo është edhe në kuadër të ligjit "Për të drejtën e informimit dhe të transparencës" ku besoj se edhe ju e keni programin e transparencës, si të gjitha institucionet e tjera.

Zonja kryetare, në linjë të sugjerimit që bëra dje në mbledhjen komisionit, ne mund të zhvillojmë takime të përbashkëta si dhe seanca dëgjimore për të parë se çfarë është bërë me këto projekte, qoftë me Kosovën dhe me Shkodrën, sepse para disa kohësh kemi kaluar edhe një projekt për pjesën e Bunës dhe Malit të Zi. Unë jam një deputete shumë e vëmendshme, por tani mësova që paskemi projekte edhe në Jugun e Shqipërisë. Me kë e kemi? E kemi me Greqinë? E kemi me Maqedoninë? Çfarë projektesh janë këto? A janë projekte për infrastrukturë, për komunikimin apo janë thjesht promovime të turizmit? Unë mendoj se impakti matet lehtësisht (ne të gjithë kemi përvojat tona me projektet, siç është ai i IPA-s), sepse raportimet janë 3-mujore, 6-mujore, e të tjera. Nuk t'i disburson IPA fondet, në qoftë se ti nuk bën një raport dhe të marrësh një audit ndërkombëtar që të monitorojë shpenzimet e fondeve.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zonja Htysi!

Meqenëse jemi në limitet e kohës, sepse duhet t'u lëmë mundësi edhe anëtarëve që të shkojnë te komisionet e tjera, mendoj që ta kalojmë projektligjin për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje kështu siç është. Mendoj se nuk është e nevojshme që ne t'ju dërgojmë një shkresë zyrtare, sepse ju do t'i reflektoni të gjitha pretendimet tona dhe do të na sillni informacionin e duhur.

Mua nuk do të më vinte mirë që të linim një afat kohor, sepse nuk jemi në klasë të parë, por besoj se brenda muajit shtator ju do të na e mundësoni këtë informacion. Kështu që ne jemi në pritje të këtij informacioni për gjithçka që kërkuam. Më vonë, mbase, do të organizohemi edhe në një takim informal lidhur me mënyrën se do ta organizojmë monitorimin, si do të shkojnë projektet, sigurisht aty ku ne do të mundemi, apo si të mundësojmë një bashkëpunim më të ngushtë për çka propozuam dhe thamë. Kështu, nëse jeni dakord, kalojmë në procedurën e votimit.

Kush është dakord për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje? Kundër? Nuk ka. Abstenim?
1 abstenim.

Miratohet.

Neni 1. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi ligjin.

Mimi Kodheli - Ju faleminderit!

E konsideroj të miratuar këtë projektligj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.09.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin për lehtësimin e tregtisë dhe të transportit në Ballkanin Perëndimor me qasje programatike me shumë faza.”

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Ditmir Bushati, Eglantina Gjermeni, Ralf Gjoni, Vasil Sterjovski, Andrea Marto, Adnor Shameti, Ervin Bushati, Vasilika Hysi, Ligoraq Karamelo dhe Rudina Hajdari.

Mungojnë:

Elona Hoxha dhe Evis Kushi.

Të ftuar:

Erjon Luçi - Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Mimi Kodheli - Kalojmë te projektligji i dytë.

Kush do ta marrë fjalën, ju zoti Luçi apo zoti Dedja?

Ju lutem, zoti Luçi, ne ezauroam gjithçka që kishim për të thënë për ratifikimin e marrëveshjes së kësaj natyre kështu që kërkoj në mënyrë shteruese, ashtu siç di të jetë mendja juaj, dy fjalë për projektligjin e dytë.

Fjala për ju.

(Diskutime pa mikrofon)

Faleminderit!

Erion Luçi – Faleminderit, zonja kryetare!

Ju uroj ditëlindjen!

Ky është një projekt inovativ që e ka ndërmarrë edhe Banka Botërore, prandaj doja ta vija në këtë kontekst, përtej relacionit, i cili është praktikisht një zgjerim edhe i projektit të mëparshëm të zonave ndërkufitare, por që përfshin edhe komplet rajonin. Është një iniciativë që edhe vetë qeveria jonë e ka kërkuar më përpara, për intensifikimin e bashkëpunimit apo të projekteve në nivel rajonal, jo thjesht në nivel vendi.

Në fakt, janë dy projekte, projekti që po prezantojmë sot, por edhe një projekt që do t'ju vijë së shpejti, edhe ai është një projekt shumë i mirë për barazinë gjinore, mbështetje buxhetore, të cilën Banka Botërore po e aplikon për herë të parë në aspektin rajonal. Ky është një projekt me dy faza. Faza e parë është ndarë në mënyrë oportuniste meqë jo të gjithë vendet ishin në të njëjtën shpejtësi, janë Maqedonia, Shqipëria dhe Serbia, e cila do të shkojë deri në vitin 2023, ndërsa faza e dytë është me vendet e tjera Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë dhe Mali i Zi, e cila do të shkojë deri në vitin 2025.

Objektivi kryesor i projektit, që është rreth 17 milionë dollarë për Shqipërinë, ndërkohë që projekti total për gjithë rajonin është 90 milionë, është shkurtimi dhe ulja e kostove të transportit dhe tregtisë mes këtyre vendeve, duke filluar nga porti i Durrësit deri në Qafë-Thanë, si dhe i gjithë korridori i Ballkanit deri në Serbi dhe përtej.

Në doganën e Durrësit synohet implementimi i një sistemi të qendëruar, i cili synon përveç të tjerave edhe përputhshmërinë me një direktivë europiane të mënyrës se si zhdoganohen mallrat, por nga aspekti i përdoruesit apo nga aspekti i Shqipërisë, kjo do të sigurojë një dhënie zhdoganimi në kohë dhe marrjen e të gjitha licencave të mundshme që duhen për zhdoganimin direkt në atë dritare. Unë mund t'ju jap më shumë detaje, por ideja është që subjekti nuk ka nevojë të shkojë në vende të ndryshme për të bërë zhdoganim. Është *one stop shop* në atë aspekt.

Gjithashtu, edhe investimi i komponentit të dytë synon pikërisht uljen e kohëve të kalimit të mallrave në doganën Qafë-Thanë-Mali i Zi, por si synim është ulja e kostove që janë llogaritur vetëm për Shqipërinë, për komponentin e parë që të mund të kursejnë për një model prej 10 vjet rreth 130 milionë euro, ndërkohë që koha e transportit mund të kursejë rreth 5 milionë euro.

Pra, në terma financiarë dhe ekonomikë është një kredi relativisht shumë e volitshme, përtej objektivit kryesor që është në linjë me një iniciativë, që prej kohësh është nisur përmes CEFTA-s, por nuk ka ecur me atë shpejtësi që do të donim të ecte. Kjo është pikërisht në linjë për t'i dhënë një shtyrje, ku zoti Bushati, jam i sigurt që e ka ndjekur edhe më afër procesin e Berlinit, është prapë brenda asaj ombrelle, e cila fokusohet në projektet ballkanike jo thjesht në projekte të vendit të veçantë.

Për më shumë pyetje dhe detaje, mbetem i hapur, por thjesht si begraund i përgjithshëm.

Mimi Kodheli – Faleminderit, Zëvendësministër!

Ka pyetje?

Fjala për relatorin.

Relatori – Komisioni për Politikën e Jashtme është në cilësinë për dhënie mendimi. Ratifikimi i marrëveshjes synon marrjen e një kredie në shumën 17,6 milionë euro dhe mbështet projektin për lehtësimin e tregtisë dhe transportit në Ballkanin Perëndimor me qasje programatike me shumë faza.

Dy nga fazat kryesore, një periudhë 5 vjet secili, faza e parë mbulon 3 nga vendet e Ballkanit Perëndimor: Shqipërinë, Maqedoninë Veriore dhe Serbinë të konsideruara gati për zbatim dhe të përfshijë një kombinim të investimeve dhe asistencës teknike dhe reformave rregullatore dhe insitucionale.

Faza e dytë e programit përfshin 3 vende të tjera të rajonit: Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën dhe Malin e Zi. Rezultatet e pritshme për realizimin e këtij projekti, të cilat janë të lidhura me objektivat e zhvillimit të fazës së parë janë: reduktimi i kostove të tregtisë, rritja e eficiencës së transporteve në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe në Serbi.

Projektligji është planifikuar për t'u implementuar gjatë periudhës 2019-2025, ndaj e ftoj komisionin ta votojmë dhe miratojmë këtë projektligj.

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Ka pyetje?

Ditmir Bushati – Zoti Zëvendësministër, faleminderit për prezantimin!

Jam i bindur që kushdo që e dëgjon nuk ka asnjë lloj kundërshtie nga nevoja për ta lehtësuar edhe më tej jo thjesht tregtinë mes vendeve të Ballkanit Perëndimor, por shumë më tepër se kaq. Megjithatë, kur ne propozojmë një akt, në radhë të parë si deputetë kemi nevojë për të kuptuar më mirë yllin polar politik, pra shtysën që e ka çuar shtetin shqiptar për të shkuar drejt kësaj marrëveshjeje.

Ju me të drejtë përmendët Procesin e Berlinit dhe unë do të kisha nevojë për më tepër informacion për lidhjen konkrete të marrëveshjes që do të miratojmë sot me Procesin e Berlinit, si dhe arsyet pse jemi 3 dhe jo 6, duke qenë se në Procesin e Berlinit të paktën jemi 6 vende të Ballkanit Perëndimor, plus vende kufitare që janë anëtare të Bashkimit Europian, ndërlidhjen e gjithë këtij procesi me konstatimet e Bankës Botërore, që sa ditë humbasin bizneset qoftë nga burokracitë, nga mungesa e unifikimit të procedurave apo standardizimit të tyre mes vendeve të Ballkanit Perëndimor, parashikime qoftë edhe të mjegullta për shtimin e investimeve të huaja në proporcion të drejtë shpresoj me këtë gjë që po bëjmë.

Së fundi, por jo më pak e rëndësishme, edhe me përpjekjet që ka bërë BE-ja me vendet tona, kur them BE-ja kam më tepër parasysh Komisionin Europian për krijimin e zonës së unifikuar të tregut në Ballkanin Perëndimor, në këtë kontekst na duhet edhe një analizë e karakterit politik (e shoh relacionin dhe, për hir të së vërtetës, është ai relacioni standard), cili do të ishte impakti i këtij veprimi që ndërmarrim me diskutimet që kemi bërë këtu, për shembull, për lëvizjen e lirë të njerëzve, kur dihet që vendet tona kanë obligime karshi BE-së kur dihet që standardi edhe aty nuk është i unifikuar. Pra, këto janë disa elemente që do të na duhet t'i dimë. Më pas, huaja, përqindja, interesi, skeduli e të tjerë, për hir të së vërtetës, nuk janë të këtij komisioni.

Unë dua t'i sugjeroja kryetares që herën tjetër... Për këtë lloj akti nuk duhet të ishim ne komision për dhënie mendimi, sepse, në radhë të parë, gjykimi duhet të jetë i karakterit politik, ndërsa çështjet, për të cilat ju folët mund t'i trajtojë fare mirë Komisioni i Ekonomisë dhe Financës, që janë çështje të karakterit financiar. Ne jemi këtu përballë këtyre dilemave, të cilat unë besoj se duke ju njohur ju dhe profesionalizmin tuaj, shkojnë përtej mandatit të institucionit që ju përfaqësoni, qoftë trashja e vendeve, qoftë ndërlidhja me ato procese për të cilat ju folët, qoftë edhe shqetësimi që shprehin gjithë kolegët, pavarësisht forcave politike që përfaqësojnë, ne duam të kemi mundësi që t'u tregojmë qytetarëve të zakonshëm të këtij vendi që përmes një akti apo një akti tjetër jeta e tyre ndryshon në mënyrë të përditshme.

Faleminderit!

Mimi Kodheli- Faleminderit, Ministër!

Unë kam një pyetje për ju, zoti Luçi. Në gjykimin tim modest, për lehtësimin e tregtisë së transportit në Ballkan ka një mënyrë dhe një mjet akoma efikas të bërjes së transportit dhe tregtisë që është ai hekurudhor, sistemi ferrovial. A kemi ndonjë shpresë që do të fillojmë me një projekt madhor, i cili do të na mundësojë uljen e kostove të transportit dhe lehtësimin e transportit? Në këtë rast nuk flas vetëm për transport për tregtinë, por edhe për transportin qytetar, turizmin dhe kështu me radhë. Për fatin tonë të keq, ne jemi i vetmi vend në Europë që nuk ka një sistem hekurudhor, është inekzistent. Edhe atë që e mbajmë, nuk e di pse e mbajmë, sepse duke e parë se ku ka mbërritur teknologjia e transportit hekurudhor, yni është thjesht primitiv, primordial. A ka një projekt të tillë dhe a do të vijë një ditë që do ta shikojmë veten rishtaz në tren, edhe si mall, edhe si frymorë?

Fjala për ju.

Erjon Luçi- Faleminderit, zonja kryetare!

Duke filluar nga e pyetja fundit, dua t'ju them se ka një projekt, që e kemi diskutuar në këtë komision para disa kohësh. Ne kemi bërë përpjekje që të ishte nisur, ndërkohë por për arsye procedurale, prapë si gjithmonë, vonohen. Është Tirana, Durrësi dhe Rinasi, aeroporti, që është një investim shumë i leverdishëm, si ky investim që po diskutojmë tani, që është 35 milionë grant, përtej të ardhurave që mund të krijohen edhe nga transporti urban, edhe nga transporti i mallrave. Ne shpresojmë që me ligjin e ri, që është bërë për transportin hekurudhor, kjo të ndihmojë edhe në modernizimin e menaxhimit të sektorit dhe të ndarjes ndërmjet infrastrukturës, shërbimit, pak a shumë reforma që po ndodhin dhe në sektorë të tjerë të infrastrukturës, siç është energjia. Ne shpresojmë dhe po synojmë që në 4-5 vjet kohë t'i japim këtij sektori një farë drejtimi, në mënyrë që ta bëjë sektorin sa më komercial të jetë edhe ndihmë për ekonominë. Ka edhe plane të tjera, por që janë gjëra pak më gjeopolitike, më saktë të sigurohet lidhja përtej Malit të Zi, edhe me Greqinë, por që janë më afatgjata. Ai do të ishte synimi final, por do të ishte mirë që të bëhej në mënyrë të sekuencuar, në mënyrë që ndërmarrja të tregojë një qëndrueshmëri financiare përpara se të hedhim lekë pa marrë të ardhura të menjëhershme. I jap shumë të drejtë zotit Bushati për *background-in*, sepse edhe unë e ndjeva kur po vija në komision që ishte pak i limituar. Në fakt, kam kërkuar informacion shtesë pikërisht në këtë kontekst, jo fiks në atë politik, por që mund t'ju jap dhe t'ju dërgoj pak më vonë edhe analizën ekonomike. Në aspektin politik, si ekonomist që jam, dua të përmend pjesën e komponentit të tretë, i cili ka mbështetjen, edhe me konsulencë, edhe me trajnime, e EU-së, që do të thotë se është një projekt ngushtësisht i lidhur me Brukselin, në aspektin e mënyrës si donatorë të ndryshëm koordinojnë përqasjen e tyre në këtë vend. Domethënë është një projekt që e ka marrë, është konsultuar ngushtësisht

me partnerët kryesorë të Procesit të Berlinit; një shpjegim i thjeshtë, por që është në atë vazhde. Praktikisht nisi pas atij procesi, që u nxit nga qeveria jonë si kërkesë ndaj donatorëve dhe u piketua Banka Botërore si më e shpejta dhe më dinamika për ta jetësuar. Vërtet ka qenë sfiduese, me aq sa e kam ndjekur unë, sepse fillimisht ka qenë shumë e vështirë të sillje 6 vende përnjëherë. Fakti është që përsëri nuk arrihet dot që t'i kesh të gjitha gati në një moment. Unë jam surprizuar vetë, pra flas si proces, që u arrit një projekt i tillë, sepse vërtet ishte shumë sfidues. Por shpresojmë që edhe implementimi të jetë relativisht i shpejtë që nga dixhitalizimi i doganës, qendërzimi i dokumentacionit dhe sistemi i informacionit të portit të Durrësit për hyrjen e daljeve të anijeve, që përsëri do ta shkurtojë kohën e lëvizjes.

Mimi Kodheli – Urdhëroni, zonja Hysi!

Vasilika Hysi - Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti Luçi!

Po lexoj relacionin, dhe më bën përshtypje që te vlerësimi projektaktit, në raport me programin politik të Këshillit të Ministrave, është vetëm një fjali, ku thoni se ky projekt nuk është përfshirë në programin analitik.

Së pari, këto projekte kaq të rëndësishme, që kanë marrë kohë në negociim, pra që nuk janë të minutës së fundit, pse nuk përfshihen dhe nuk planifikohen në kohë?

Së dyti, ne në muajin korrik, para se Këshilli i Ministrave ta shqyrtonte këtë projektligj dhe ta përcillte në Kuvend, kemi bërë një ndryshim të nenit 68 të Rregullores së Kuvendit, që flet për propozimin e projektligjeve, ku, ndër të tjera, është kërkuar që projektligji që hartohet, pra që vjen nga Këshilli i Ministrave, por jo vetëm, duhet detyrimisht të përmbajë disa informacione në relacion. Ndër të tjera, është ndikimi ekonomik, social, mjedisor dhe ndjeshmëria gjinore e projektit, shkalla e përmbushjes së objektivave të axhendës së zhvillimit të qëndrueshëm (te objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara kemi edhe infrastrukturën, zhvillimin e qëndrueshëm të tjerë), njëkohësisht edhe efektet financiare të pritshme që rrjedhin nga zbatimi. Pra, jo thjesht të merret kjo kredi, kjo hua, por të dimë sa do të paguajë Shqipëria kur të fillojë disbursimi? Madje, është shtuar edhe një paragraf, që, në mënyrë të arsyetuar, Kryetari i Kuvendit mund ta kthejë nismën, nëse nuk përmbushet një nga kërkesat që parashikohet në këtë, nen. E thashë këtë bashkë me pyetjen që bëra, pse nuk është përfshirë në programin analitik, edhe si një sugjerim, meqenëse jemi në fillim të sesionit parlamentar. Ndoshta Rregullorja nuk është studiuar siç duhet edhe nga stafet, sepse nuk është detyra juaj, por të paktën në të gjitha nismat që qeveria sjell dhe ju jeni një ndër ministrinë që keni numrin më të madh të nismave dhe besoj se do të keni deri në fund të vitit, ju lutem, të mbahet në

konsideratë neni 68 i Rregullores së Kuvendit, ku të ketë në mënyrë të detajuar informacion për çdo kërkesë të pikës 2 të këtij neni, njëkohësisht, kjo është edhe për transparencë dhe për informim, me qëllim që deputetët jo thjesht të ngrenë dorën dhe të votojnë huat grantet dhe të mos dinë se si përdoren dhe ku përdoren.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Zoti Sterjovski, fjala për ju.

Më pas fjalën do ta keni ju, zoti Zëvendësministër!

Vasil Sterjovski – Faleminderit, zonja kryetare!

Dua të pyes zotin zëvendësministër, a ka ndonjë plan, ndonjë ide për autostradën Elbasan- Qafë-Thanë për t'u lidhur me Maqedoninë, gjë që do të lehtësonte transportin, lidhjen me Maqedoninë, me Greqinë dhe do të kishte impakt direkt në zhvillimin e turizmit në Shqipëri, duke marrë shkas edhe nga numri shumë i lartë i turistëve maqedonas, që vijnë në bregdetin shqiptar. Besoj se me ndërtimin e kësaj autostrade do të vinin më shumë Shqipëria do të ishte më atraktive, sepse lëvizja do të ishte më e lirë dhe më e shpejtë, sepse përveç Maqedonisë, do të lidheshin edhe tri shtete. Pastaj, Maqedonia mund të vazhdonte edhe në pjesën e Qafë-Thanës, Bitolës me Greqinë. Pra, është një kërkesë reale...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Zoti Zëvendësministër, ju lutem!

Erjon Luçi – Jo, nuk kam justifikim për zonjën Hysi.

Unë e mora shënim, por e kam si sugjerim edhe për sistemin që po vendosim ne, i cili mund të sigurojë edhe disa nga këto detyrime, sidomos, për shembull, për ndikimin ose për shpërndarjen e barazisë gjinore. Ne do të mundohemi që ta fusim për çdo projekt, të paktën që t'i ketë këto elemente që në fillim, kur propozohet.

Është e vërtetë që edhe unë sa herë e lexoj relacionin, mendoj se ka blloqe ku mund të ishte bërë punë... Këto janë projekte që relativisht, të paktën pjesën mjedisore e kanë detyrim, sepse është e pamundur të mos ketë pjesë mjedisore. Por është një sugjerim dhe një koment i saktë që nuk mund ta justifikoj. Do të mundohemi ta përmirësojmë.

Për sa i përket segmentit Tiranë-Elbasan-Qafë Plloçë, janë bërë segmente... Segment i parë që u mbarua është ai Tiranë-Elbasan, pastaj Qukës-Qafë Plloçë është një segment që ka hasur vështirësi në aspektin gjeologjik dhe mund të kërkojë përsëri shtesa. Kështu që mund të diskutohet që të plotësohet edhe pjesa e mesit në një kohë të dytë. Por me kapelën e financës unë do të isha pak më gradual. Përfitimi ekonomik është gjithnjë shumë i qartë dhe i dëshiruar, por gjithmonë ka elemente të financimit, të cilat duhet të përputhen edhe me

njëfarë ngarkese borxhi që mund ta përballojmë. Për momentin, le të themi, portofoli i transportit është vërtet shumë i madh.

Një tjetër element që mund të krijojë gradualitet në plotësimin e akseve kryesore është edhe plotësimi i akseve aktuale, duke përfshirë edhe atë të Kosovës, për shembull, me rrugë ndihmëse rurale. Domethënë, ndërkohë që bëhet një aks aq i madh dhe rrugët që hyjnë e dalin janë përsëri të limituara, ulen edhe të ardhurat ekonomike... E njëjta gjë mund të thuhet edhe për rrugë të tjera, përveç sigurisë rrugore dhe mirëmbajtjes, që janë çështje që nuk mund të anashkalohen më në aspektin e një kostoje, që është relativisht nga 50 në 100 milionë euro në vit, në qoftë se mund të flasim në euro. Kështu që do të kërkoja mirëkuptimin tuaj për ta parë këtë në një kuadër pak më të gjerë të plotësimit të infrastrukturës brenda limiteve që kemi.

Kemi pasur një periudhë relativisht komode në aspektin e financimeve, edhe me ndihmën e donatorëve, por periudhat gjithmonë mund të ndryshojnë. Prandaj duhet të përgatitemi edhe për rastet kur këto financime mund të jenë të limituara ose kur kostot rriten shumë. Domethënë, është pak e balancuar si përjasje. Por dy segmente janë bërë, ndërkohë që diskutohet thjesht segmenti i mesit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Për të mos prishur solemnitetin e mbledhjes, pavarësisht eventeve personale, e hedhim në votë marrëveshjen që kemi përpara.

Zoti Luçi, faleminderit! Unë mendoj se është momenti ta hedhim në votë.

Kush është dakord në parim me ratifikimin e kësaj marrëveshjeje? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Edhe një herë, për procedurë, e hedhim në votim në tërësi marrëveshjen.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe në tërësi.

Faleminderit!

Në fakt, dua të falënderoj në mënyrë shumë të veçantë anëtarët josocialistë të këtij komisioni për të gjithë bashkëpunimin, mbështetjen dhe votimin realisht të atyre çështjeve me interes të përbashkët; e theksoj, në mënyrë shumë të veçantë, me zemër!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit, zoti Zëvendësministër dhe punë të mbarë!

Mbledhjen e konsideroj të mbyllur.

MBYLLET MBLEDHJA